



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS - SHITIME
Komiteti për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport
Nr.01-060/01-15328/23 datë:21.06.2023



Npi – 01/258 datë: 26.06.2023

Duke u bazuar në nenin 51.2 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr.03/L-040 (GZ Nr.28, datë 04.06.2008); Nenit 36 dhe 37.4 të Statutit të Komunës së Shitimes; Nenin 13 dhe 17 të Udhëzimit Administrativ të (MPL) Nr.05/2020 për Procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e Komiteteve të përhershme dhe Komiteteve tjera në Komunë; Si dhe në bazë të nenit 4.13 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve Npi-01/155 të datës 26.05.2023, Komiteti për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport në mbledhjen e mbajtur më: 26.06.2023, nxjerr këtë:

E K S T R A K T
PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË -V- TË KOMITETIT PËR ARSIM KULTURË RINI DHE SPORT
të mbajtur më datën: 26.06.2023 (e hënë) në ora 14:00 h. në sallën e vogël

Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesja, znj.Albana Podvorica, Anëtarët e Komitetit: z.Asllan Beqaj, z.Hamëz Tërshani dhe z.Rexhep Gashi. Përveq anëtarëve të Komitetit në mbledhje kanë marrë pjesë edhe: Praktikantët, znj.Valmira Hoxha dhe znj.Sadbere Halili.

Mbledhjen e hapi Kryesuesja e Komitetit, znj.Albana Podvorica, e cila pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, Konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm për mbajtjen e mbledhjes. Për këtë mbledhje është propozuar ky:

REND DITE

1. Shqyrtimi i Ekstrakt-Procesverbalit nga mbledhja e KAKRS e mbajtur më 26.04.2023,
2. **Analizë 6 Mujore e punës së DKA-së dhe DKRS-së,**
3. **Informatë rreth organizimit të aktiviteteve rekreative me fëmijët me nevoja të veçanta nga DKA dhe DKRS,**
4. **Informatë nga DKRS mbi aktivitetet në palestrën e qytetit,**
5. **Informatë nga DKA rreth organizimit të shkollës verore, dhe regjistrimin e nxënësve në shkollat e mesme të larta.**

Kryesuesja, znj.Albana Podvorica; Hapi diskutimin për rendin e ditës.

z.Rexhep Gashi; Përshëndetje, jam në pajtim me pikat e rendit të ditës, por me pikat që nuk janë prezent drejtorat dhe ka mungesë të informatave le të tërhiqen, deri sa nuk janë prezent drejtorat mendojë që duhet me i shty këto pika.

z.Asllan Beqaj; Përshëndetje, i bashkëngjitem diskutimit të Rexhës.

z.Hamëz Tërshani; Jam i pajtim me parafolësit dhe, po e shoh një raport 6 mujor të DKRS-së se si ka mundesi me u bë ky raport pa u përfunduar muaji i 6 Qershor. Ne e kemi lënë punën për me ardhë në mbledhje të Komitetit, kjo është shumë jo seriozitet nga ana e drejtorëve që nuk janë prezent në mbledhje.

Kryesuesja, znj.Albana Podvorica; Është ky raport 90% i njejtë me herën e kaluar. Pajtohem edhe unë që me u tërhek këto pika.

***Komiteti për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport, unanimitisht vendosi që pikat 2, 3, 4 dhe 5 të hiqen nga rendi i ditës me arsyetimin se nuk janë prezent drejtorat e DKA-së dhe DKRS-së dhe kemi mungesë të informatave.**

Pika 1



Shqyrtimi i Ekstrakt-Procesverbalit nga mbledhja e KAKRS e mbajtur më 26.04.2023

Kryesuesja, znj.Albana Podvorica; Hapi diskutimin për këtë pikë.

***Komiteti për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport, unanimitisht miratoi, Ekstrakt-Procesverbalin nga mbledhja e kaluar e mbajtur më 26.04.2023.**

Kryesuesja, znj.Albana Podvorica; Pasi që diskutime të tjera nuk kishte, dhe në mungesë të drejtorëve në mbledhje dhe informatave të DKA-së dhe DKRS-së Kryesuesja mbledhjen e përfundoi në ora 14:20h.

Procesmbajtës
Valmira Hoxha



Kryesuesja e Komitetit
Albana Podvorica

